




ILD
INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Një përmbledhje e shkurtër e institucionit 2025





Co-funded by
the European Union

EU IV JUSTICE

Implemented by:



ITALIAN AGENCY
FOR DEVELOPMENT
COOPERATION



INTEGRITY
INTEGRITY
INTEGRITY

In partnership with:

**EXPERTISE
FRANCE**
GROUPE AFD



FIIAPP | 
COOPERAZIONE ITALIANA

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Një përmbledhje e shkurtër e institucionit

Përgatitën: Mimoza Koçiu, Dëshira Pasko, Isida Koka

Ndihmuan: Elis Kuçi, Zilije Feci

Përktheu: Pavli Treska

PËRMBAJTJA

- 1 NJË MODEL I UNIFIKUAR INSPEKTIMI
- 2 ORGANIZIMI (STRUKTURA ORGANIZATIVE)
- 3 KOMPETENCAT
- 4 FUNKSIONET E ILD-SË
- 5 INSPEKTIMI DISIPLINOR
- 6 KARTA E TË DREJTAVE TË QYTETARËVE
- 7 RREGULLORJA E PRITJES SË QYTETARËVE
- 8 PROFILI NDËRKOMBËTAR
- 9 FILOZOFIA E PUNËS

1. NJË MODEL I UNIFIKUAR INSPEKTIMI

Një model i ri inspektimi



ILD NIS FUNKSIONIMIM

MË 1 SHKURT 2020

Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) ka filluar nga puna më 1 Shkurt 2020, si institucion i ri i pavarur kushtetues.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror i ngarkuar me verifikimin e ankesave, me hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm (neni 147/d i Kushtetutës së Shqipërisë). Inspektori i Lartë i Drejtësisë është gjithashtu përgjegjës për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Deri në korrik 2016, kontrolli i magjistratëve kryhej nga tri institucione të veçanta: ministri i Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (për gjyqtarët) dhe Prokurori i Përgjithshëm (për prokurorët). Në korrik 2016, Shqipëria ndërmori një reformë të thellë në sistemin e drejtësisë, duke ngritur një arkitekturë të re të institucioneve të drejtësisë. Në kuadër të kësaj reforme, inspektimi gjyqësor është riorganizuar në një institucion monokratik, që është Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Zgjedhja

Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me shumicën e tri të pestave të 140 anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje. Ai përzgjidhet ndër radhët e juristëve të spikatur, me jo më pak se 15 vjet përvojë në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional, nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas një procedure transparente dhe publike. Inspektori i Lartë i Drejtësisë gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Z. Artur Metani është Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i zgjedhur më 20 janar 2020, me 98 vota pro të Kuvendit të Shqipërisë.

Pavarësia

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është drejtues i institucionit dhe i ushtron funksionet e veta në pavarësi të plotë. Ndërhyrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në funksionet e Inspektorit për kryerjen e verifikimeve të ankesave, hetimeve dhe inspektimeve, ose në lidhje me ndonjë subjekt të caktuar shkakton përgjegjësi sipas ligjit.

Me kuvendin

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është person juridik me një buxhet të pavarur, pjesë e buxhetit të shtetit, që miratohet nga Kuvendi. Organizimi, struktura dhe numri i punonjësve të Zyrës së Inspektorit miratohen nga Kuvendi, me propozim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen raportim vjetor mbi veprimtarinë e institucionit në Parlamentin e Shqipërisë dhe jep informacione periodike mbi punën e vet, sipas kërkesës së Kuvendit.

2. ORGANIZIMI

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) është projektuar si një institucion i pavarur kushtetues, organizuar dhe që funksionon si entitet juridik me një buxhet të veçantë të financuar nga buxheti i Shtetit, dhe nga burime të tjera financiare të parashikuara në ligj, me një strukturë dhe personel të nevojshëm profesional për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore.

Në përmbushje të veprimtarisë së tij kushtetuese dhe ligjore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka këtë strukturë organizimi:

- **Kabineti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**, veprimtaria e të cilit, përveç detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendshme, shërben në konsultimin dhe ndjekjen e çështjeve dhe detyrave specifike, të caktuara rast pas rasti nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
- **Njësia e Inspektorëve**, ka në përbërje inspektorë magjistratë dhe inspektorë jo magjistratë, në ndarje të barabartë. Veprimtaria e kësaj njësie rregullohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, përgjegjëse për kryerjen e verifikimeve, hetimeve disiplinore ndaj veprimtarisë së gjyqtarëve e prokurorëve të të gjithë niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë së Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe inspektimeve tematike e institucionale.
- **Njësia e Ndihmës Inspektorëve**, ka në përbërje juristë me eksperiencë mbi 10 vjeçare, të cilët mbështesin Njësinë e Inspektorëve në fazën para-hetimore dhe pas-disiplinore.

- **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike dhe Integritit** ka dy drejtori:
- **Drejtoria e Integritit, Analizës dhe Monitorimit**, që përmban *Sektorin e Raportimit dhe Integritit* dhe *Sektorin e Analizës dhe Monitorimit të Rekomandimeve të Inspektimit*. Kjo drejtori përgatit raporte, dokumente strategjike dhe çdo dokument tjetër, kërkon të dhëna mbi veprimtarinë e përgjithshme për angazhimet e marra, në kuadër të procesit të integritit evropian; bën përpunimin dhe analizën e të dhënave statistikore mbi veprimtarinë e ILD-së, për përdorim nga institucioni, por edhe me qëllim rritjen e transparencës së punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- **Drejtoria e Shërbimeve Juridike**, përfshin *Sektorin e Hartimit të Akteve dhe Përputhshmërisë*, *Sektorin e Shërbimeve Juridike* dhe *Sektorin e Ndihmës dhe Koordinimit të Informacionit*. Kjo drejtori merret me hartim e verifikim të akteve e dokumentacionit të brendshëm, jep mendim juridik, kryen analiza dhe punë kërkimore, ndjek asistencën për qytetarët, ecurinë e ankesave dhe kërkesat për informacion, si dhe çdo dimension të marrëdhënieve me publikun të institucionit.
- **Sektori i Buxhetit dhe Financës** është i angazhuar për përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë.
- **Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse** përfshin *Sektorin e Burimeve Njerëzore*, *Sektorin e Teknologjisë së Informacionit*, *Sektorin e Arkiv Protokollit*, si dhe *Sektorin e Shërbimeve të Përgjithshme*, me funksione mbështetëse për institucionin.

3. KOMPETENCAT

Kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

- Inspektori i Lartë i Drejtësisë është titullari i institucionit dhe përfaqëson Zyrën e Inspektorit në marrëdhëniet me palët e treta;
- Siguron bashkëpunimin e Zyrës së Inspektorit me subjektet e tjera publike dhe private gjatë ushtrimit të funksioneve të saj;
- Nxjerr urdhra të përgjithshëm të natyrës administrative ose procedurale për ecurinë dhe metodat e punës, për bashkërendimin e punës ndërmjet inspektorëve, ose ndërmjet tyre dhe organeve të tjera publike, për garantimin e interpretimit dhe zbatimit uniform të ligjit për verifikimin e ankesave; hetimin e sjelljeve të pahijshme dhe inspektimin, për sigurimin e respektimit të rregullave të performancës etike dhe profesionale nga inspektorët dhe personeli administrativ, si dhe për çdo çështje tjetër të natyrës së përgjithshme pas marrjes së mendimit të mbledhjes së inspektorëve;
- Nxjerr urdhra jodetyruese për rastet konkrete të trajtuara nga inspektorët;
- Raporton në Kuvend, jo më pak se një herë në vit, për punën e Zyrës së Inspektorit në vitin paraprak;
- Miraton planin vjetor të inspektimeve institucionale dhe tematike;
- Përcakton kriteret e kualifikimit dhe kërkesat e tjera për pozicionin e inspektorëve dhe personelit administrativ, në përputhje me këtë ligj, ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit “Për nëpunësin civil”;
- Mbikëqyr dhe menaxhon metodologjikisht punën e inspektorëve;
- Heton sjelljet e pahijshme disiplinore të inspektorëve;

- Thërret dhe drejton Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve;
- Thërret dhe drejton mbledhjet e Komisionit të Emërimeve dhe Vlerësimit të Inspektorëve;
- Mbikëqyr dhe drejton administratën e Zyrës së Inspektorit;
- Ndan rastet tek inspektorët dhe vendos për zëvendësimin e tyre në bazë të kriterëve objektive dhe transparente, duke marrë parasysh ngarkesën, përvojën, kualifikimet dhe pengesat e mundshme ligjore të inspektorëve;
- Miraton projektvendimet e inspektorëve;
- Kryen çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

Detyrat e inspektorëve

- Inspektorët kryejnë detyrat e tyre në emër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Gjatë marrjes së detyrës, inspektorët verifikojnë dhe hetojnë për shkelje të supozuara disiplinore të subjekteve, të cilat janë pjesë e fushës së kompetencës së ILD-së; mbledhin të dhëna dhe vlerësojnë çdo informacion ose veprim, që ata e konsiderojnë, ose mund të jetë i rëndësishëm për zbatimin e detyrës.
- Inspektorët kanë të drejtë të hyjnë në mjediset ku veprojnë subjektet e procedimit disiplinor, të inspektojnë, kopjojnë, shumëzojnë dhe marrin çdo informacion ose dokument të nevojshëm për kryerjen e detyrës.
- Inspektorët kërkojnë nga çdo person fizik ose juridik ose institucion publik informacion, dokumente, prova, me gojë ose me shkrim, për çdo çështje që lidhet me çështjen e verifikimit, hetimit ose inspektimit që po kryhet.
- Në përfundim të procedurës së verifikimit, hetimit të keq sjelljes ose inspektimit, inspektori harton vendimin përkatës dhe ia dorëzon menjëherë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

4. FUNKSIONET


- Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.
- ILD kryen inspektime tematike e institucionale nëpër Gjykata dhe Zyrat e Prokurorive të të gjitha niveleve.

5. INSPEKTIMI DISIPLINOR

Inspektimi në Zyrën e ILD-së-së është i organizuar në dy njësi:

- ▶ **Trupa e Inspektorëve**, e përbërë nga 20 inspektorë, prej të cilëve gjysma magjistratë dhe gjysma jo magjistratë.
- ▶ **Njësia e Ndhmës Inspektorëve**, 23 juristë me të paktën 10 vjet përvojë.

Struktura organizative e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë



Totali 101 punonjës

Ankesat në ILD

Për verifikimin e një ankese apo hetimi për një shkelje disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vepron në bazë të:

- Një ankese me shkrim nga çdo person fizik, juridik ose organ publik;
- Ankesë me shkrim nga Ministri i Drejtësisë;
- Një ankese me shkrim nga Prokurori i Përgjithshëm;
- Ankesë me shkrim nga çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- Ankesë me shkrim nga kryetari i gjykatës ku funksionin e ushtron gjyqtari i dyshuar për shkelje disiplinore;
- Një ankese me shkrim nga drejtuesi i Prokurorisë ku ushtron funksionin prokurori i dyshuar për shkelje disiplinore;
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë heton shkeljet e supozuara edhe kryesisht, bazuar në informacione publike apo informacione të dhëna në kuadër të inspektimeve institucionale dhe tematike.

Procedura e ankimit

Për ta lehtësuar sa më shumë procesin e ankimit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka përgatitur një formë të thjeshtuar të ankesës, që mund të paraqesin qytetarët apo institucionet, nëse kanë pretendime për kryerjen e shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në faqen zyrtare të internetit www.ild.al ka një seksion të dedikuar dhe të dukshëm në lidhje me këtë proces, konkretisht:

- Një formular ankese që plotësohet online dhe dërgohet direkt në ILD, edhe përmes celularit apo kompjuterit;
- Një formular ankese për t'u shkarkuar, plotësuar dhe dërguar me email ose me postë në ILD.

- Udhëzime të hollësishme se si të plotësohet formulari i ankesës, shoqëruar me një model të plotësuar formulari, për referencë.
- Komenti shpjegues i procedurës shoqërohet me shembuj konkretë të vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për secilin nga kriteret e përcaktuara në ligj, për pranueshmërinë dhe shqyrtimin fillestar të ankesave dhe një hartë vizuale të procesit.

Paraqit Ankesë

PLOTËSO FORMULARIN E ANKESËS ONLINE

SHKARKO FORMULARIN E ANKESËS

UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË ANKESËS

MODEL ANKESË I PLOTËSUAR

PRANUESHMËRIA E ANKESËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

FORMULARI I ANKESËS

KODI I ANKESËS _____ DATA E REGJISTRIMIT ____/____/____


SEKSIONI I INFORMACION MBI TË DHËNAT PERSONALE TË ANKUESIT	
PERSON FIZIK	
Emër Mbiemër *	
Numri Personal (ID)	
Shtetëria	☐ Shqiptare ☐ E huaj _____
Mosha	_____, Vite
Adresa jua e përshkruar: * <i>(Shënim: Adresa duhet të jetë e saktë.)</i>	_____, Qarku _____
Adresa tjetër: <i>(Nëse është e nevojshme, na dërgoni adresën tuaj të tjetër.)</i>	
Adresa elektronike (e-mail personal)	
Numrat e kontaktit:	Tel. Fiks _____ Tel. Celular _____
Mënyra e dërgimit të ankesës	☐ Me postë elektronike (e-mail); ☐ Me postë zyrtare;

Adresa: Dëshmorët e Kosovës, Gafina nr. 13, Tiranë. Tel: +355 4 2217217. E-mail: ndrej@id.al

Kush e kryen procesin?

Shqyrtimi fillestar, verifikimet, hetimet disiplinore për veprimet, mosveprimet apo sjelljen gjatë ushtrimit të funksionit apo jashtë ushtrimit të tij nga ana e magistratëve mund të kryhen vetëm nga inspektorët e ILD-së.

Inspektori ka për detyrë të evidentojë dhe analizojë sjelljen dhe të kualifikojë faktet, që sipas tij përbëjnë shkelje disiplinore dhe në rast se krijohet dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e shkeljes disiplinore, propozon masën disiplinore përpara organit të disiplinës së magistratëve.



Inspektimet

- Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime institucionale dhe tematike në çdo aspekt pune të gjykatave, administratës gjyqësore, prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në një kërkesë me shkrim të motivuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Ministrit të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.
- Çdo fillim viti kalendarik, Inspektori i Lartë i Drejtësisë miraton në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve planin e inspektimeve në prokurori e gjykata për vitin vijues.
- Inspektimet kryhen si vizita në terren ose komunikim online, rutinë ose bazuar në një inspektim tematik ose verifikim/hetim të vazhdueshëm.
- Raportet e përgatitura në bazë të një inspektimi mund të sjellin procedime disiplinore.
- Raportet e inspektimeve publikohen në faqen zyrtare të ILD-së.

6. KARTA E TË DREJTAVE TË QYTETARËVE

(përgatitur nga ekspertët e EU4Justice)

Preambulë Institucionale

Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), si organ kushtetues i pavarur i Republikës së Shqipërisë, riafirmon angazhimin e tij për transparencë, integritet dhe përgjegjshmëri në sistemin e drejtësisë. Kjo Kartë e të Drejtave ka për qëllim të garantojë që çdo person që paraqet një ankesë pranë ILD-së të trajtohet në mënyrë të drejtë, me respekt dhe në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës. Përmes këtij dokumenti, institucioni shpreh vullnetin e tij për të forcuar besimin e qytetarëve dhe për të konsoliduar etikën gjyqësore si një shtyllë themelore e demokracisë.

1 E drejta e aksesit dhe paraqitjes së ankesave

Çdo qytetar ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për sjelljen profesionale ose etike të gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Ankesat mund të paraqiten me shkrim, personalisht, nëpërmjet postës elektronike ose përmes platformës elektronike të vënë në dispozicion nga ILD-ja.

Qytetari ka të drejtë të marrë udhëzime të qarta mbi kërkesat dhe procedurat e paraqitjes së ankesës.

Ushtrimi i kësaj të drejte bazohet në parimin e drejtësisë së hapur.

2 E drejta për informim dhe transparencë

Qytetari ka të drejtë të marrë konfirmim për marrjen e ankesës dhe

të njihet me numrin e regjistrimit të saj.

Konkretisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda pesë ditëve nga marrja e saj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton ankuesin vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës.

Gjatë procedurës garantohet e drejta për t'u informuar mbi statusin e çështjes, përveç fazave që i nënshtrohen konfidencialitetit.

Në përfundim të procesit, qytetari informohet mbi rezultatin dhe masat e marra.

3 E drejta për paanshmëri, pavarësi dhe objektivitet

Ankesat shqyrtohen nga inspektorët, që veprojnë në pavarësi të plotë dhe të lirë nga çdo ndikim apo presion i jashtëm.

Vendimarrja bazohet në kritere objektive, të njëjta dhe të mbështetura në prova të verifikueshme.

ILD-ja garanton mungesën e konfliktit të interesit gjatë gjithë procesit të shqyrtimit, verifikimit apo hetimit disiplinor.

4 E drejta për konfidencialitet dhe mbrojtjen e të dhënave personale

Të gjitha informacionet që lidhen me një ankesë trajtohen në përputhje me parimin e konfidencialitetit.

Qytetari mund të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit të tij/saj, kur e vlerëson të arsyeshme.

ILD-ja mbron të dhënat personale në përputhje me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale.

5 E drejta për efikasitet dhe zhvillim brenda një afati të arsyeshëm

Ankesat shqyrtohen brenda një afati ligjor tre mujor nga marrja e tyre.

ILD-ja përcakton afate orientuese për çdo fazë të procedures, duke u kujdesur që të garantohet respektimi i afateve ligjore.

Çdo vonesë duhet të jetë e arsyetuar dhe, kur është e përshtatshme, t'i njoftohet qytetarit.

6 E drejta për cilësi institucionale dhe trajtim të denjë

Qytetari trajtohet me respekt, korrektësi dhe profesionalizëm. ILD-ja siguron akses për të gjithë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara ose me barriera gjuhësore.

Për të kërkuar informacion ose për të paraqitur një ankesë nuk kërkohet përfaqësim ligjor i detyrueshëm.

7 E drejta për rishqyrtim dhe ankim

Në përputhje me parimin e procesit të rregullt ligjor, qytetari ka të drejtë të ankimojë vendimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesave dhe mbylljen e hetimit disiplinor pranë këshillave përkatëse.

8 E drejta për përgjegjshmëri dhe përmirësim të vazhdueshëm

ILD-ja publikon raporte vjetore mbi veprimtarinë disiplinore dhe masat për përmirësim.

Cilësia e shërbimit vlerësohet vazhdimisht, edhe përmes një ankete të posacme, që gjendet në faqen e internetit të ILD-së dhe promovohen praktikat më të mira në shërbim të qytetarëve. Kërkesat për informacion trajtohen në përputhje me parimin e të drejtës së informimit, transparencës dhe mbrotjes së të dhënave personale.

Anketë mbi veprimtarinë e ILD-së

I- NDERVEPRIMI ME INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË

II- TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1. A keni kontaktuar ndonjëherë me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë? *

- ☐ Një herë
- ☐ Më shumë se një herë
- ☐ Asnjëherë

2. A i/e njihni rolin dhe kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD)? *

- ☐ I/e njoh kompetencat
- ☐ Kam njohuri të përgjithshme
- ☐ Kam dëgjuar
- ☐ Nuk i njoh

3. Nëse e njihni, nga cili burim keni marrë informacion për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë? (Mund të zgjidhni më shumë se një opsion) *

- ☐ Faqja e internetit www.ild.al
- ☐ Media, rrjete sociale
- ☐ Institucione publike/fo publike
- ☐ Eksperiencë personale
- ☐ Persona të tjerë
- ☐ Tjetër (specifikoni)

4. A jeni ankuar ndonjëherë ndaj vendimmarrjes së ILD për ankesën tuaj në KLGJ apo KLP?

- ☐ Nuk jam ankuar në asnjë prej Këshillave
- ☐ Jam ankuar

5. Nëse jeni ankuar në ILD, si e vlerësoni procesin e trajtimit të ankesës tuaj?

- ☐ Në kohë
- ☐ Të vonuar
- ☐ Tjetër (specifikoni)

6. Sa të lehtë e patët plotësimin dhe dorëzimin e ankesës?

- ☐ Shumë të lehtë
- ☐ Të lehtë
- ☐ Të vështirë

9 Angazhimi institucional

Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbetet i angazhuar për një sistem disiplinor të drejtë dhe transparent.

Promovohen etika dhe përgjegjësia gjyqësore.

ILD-ja nxit besimin e publikut në drejtësi dhe modernizon proceset e saj përmes përdorimit të mjeteve digjitale.

10 Publikimi periodik

Inspektori i Lartë i Drejtësisë publikon periodikisht në faqen e tij zyrtare (<https://ëëë.ild.al>) informacion të rëndësishëm mbi funksionimin e institucionit, përpunimin e përgjithshëm të ankesave dhe lehtëson aksesin e publikut në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke ofruar formularët përkatës, një seksion me pyetje të shpeshta, si dhe duke publikuar Raportin Vjetor për çdo vit dhe legjislacionin përkatës.

Në faqen zyrtare të institucionit ka edhe dy publikime permanente: ecuria me Shifra e trajtimit të ankesave cdo javë. Këto të dhëna përditësohen cdo ditë të hënë në mëngjes. Gjithashtu, ka një publikim të përmuajshëm për veprimtarinë një mujore të institucionit, përmes një buletini të dedikuar informativ.

Klauzolë përfundimtare

Kjo Kartë e të Drejtave buron nga dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Rregullores “Për përcaktimin e standardeve për shqyrtimin e ankesave në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë” dhe “Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e ILD-së”, si dhe nga informacionet e publikuara në faqen zyrtare të ILD-së, në lidhje me formularët, raportet, pyetjet e shpeshta dhe informacionin e thjeshtuar për qytetarët. Qëllimi i saj është forcimi i marrëdhënies ndërmjet qytetarëve dhe ILD-së, duke konsoliduar transparencën, integritetin dhe përgjegjshmërinë e sistemit të drejtësisë.

7. RREGULLORJA E PRITJES SË QYTETARËVE

Për pritjen e qytetarëve që duan të paraqesin një ankesë, të marrin informacion mbi ecurinë e një ankese, të paraqesin dokumente shtesë apo të kërkojnë informacion të mëtejshëm, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ekziston një ekip i posaçëm, në Sektorin e Ndihmës dhe Koordinimit të Informacionit. Kjo njësi mes të tjerash, mbikëqyr dhënien e asistencës për qytetarët që mund të paraqiten personalisht pranë Zyrës së ILD-së ose nëpërmjet postës elektronike apo telefonit, për mënyrën se si mund të paraqitet një ankesë në ILD; mbikëqyr ndjekjen e ecurisë së ankesave nëpërmjet sistemit dhe informon ankuesin për fazën ku ndodhet ankesa e veçantë (përmes komunikimit me e-mail, me inspektorin përkatës).

Rregulla gjatë zhvillimit të takimeve me publikun

Gjatë zhvillimit të takimeve me publikun, çdo person në cilësinë e ankuesit, të afërmit të tij apo shoqërues, si edhe çdo person i cili kërkon informacion pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka të drejtë:

- Të parashtojë qëllimin e paraqitjes në institucion;
- Të kërkojë kopje fizike të formularit të ankesës dhe udhëzime për plotësimin e tij;
- Të depozitojë dokumentacion, kërkesë apo formularin e plotësuar të ankesës;
- Të informohet mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe procedurat që ndiqen për shqyrtimin e ankesave nga momenti i regjistrimit, deri në vendimarrjen përfundimtare;

- Të kërkojë informacion mbi fazën dhe ecurinë e ankesës së depozituar.

Struktura përgjegjëse për pritjen e publikut afishon pranë ambienteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rregullat e sjelljes dhe të drejtat e subjekteve në institucion.

Rregulla të përgjithshme sjelljeje brenda ambienteve të Zyrës së ILD-së

Brenda ambienteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, publiku dhe çdo subjekt tjetër ka detyrimin të respektojë rregullat e mëposhtme:

- Të fikë dhe të dorëzojë telefonin celular, çdo pajisje elektronike dhe mjetin e identifikimit, për ruajtje të përkohshme, në vende të krijuara posaçërisht për këtë qëllim;
- T'u nënshtrohet rregullave të kontrollit të sigurisë në hyrje të ambienteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave dhe çdo udhëzimi të dhënë nga punonjësi i sigurisë;
- Të qëndrojnë ulur në ambientet e caktuara nga nëpunësi i informacionit;
- Të ndjekë udhëzimet e nëpunësit të informacionit, për shoqërimin dhe lëvizjen brenda ambienteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Të respektojë çdo komunikim të strukturës përgjegjëse për pritjen e publikut, para, gjatë dhe pas takimit asistues;
- Të ketë veshje të përshtatshme për paraqitjen dhe qëndrimin në institucion;
- Të mos komunikojë për asnjë arsye dhe me asnjë person tjetër, përveç nëpunësit të informacionit, punonjësit të sigurisë, ose nëpunësve të strukturës përgjegjëse për pritjen e publikut;
- Të mos komunikojë me zë të lartë.

8. FILOZOFIA E PUNËS E ILD-SË

- **Standardet:**

Rritja e besimit të publikut për sistemin e drejtësisë në Shqipëri mbetet një sfidë për çdo institucion të drejtësisë, përfshi Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD). Kjo është arsyeja pse vendosja e standardeve dhe përafrimi i tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare për hetimin disiplinor dhe inspektimin është qëllimi kryesor i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Procedimet disiplinore të magjistratëve konsiderohen jo thjesht “ndëshkim” për ta, por standarde të drejta, të paanshme, të cilat synojnë përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e sistemit të drejtësisë, që duhen parë dhe ndjekur nga të gjithë magjistratët në sistemin e drejtësisë. Në këndvështrimin e ILD-së, drejtësia jo vetëm që duhet të vendoset, por duhet edhe të shihet që bëhet.

Si organ kushtetues i pavarur, ILD ka mundësinë të vendosë standarde të reja pune të konsoliduara nga praktika e drejtësisë, si dhe të zhvillojë kapacitetet njerëzore sipas përbërjes së fushave të ndryshme të ekspertizës dhe aplikimit të metodave të sigurta për menaxhimin e institucionit.

Ngritja e kapaciteteve për hetimin dhe inspektimet disiplinore nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe marrëveshjeve/memorandumeve të mirëkuptimit/bashkëpunimit me institucionet homologe ndërkombëtare dhe institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Si një institucion i një vendi në proces negociatash për anëtarësim në BE, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zbaton një qasje shumë energjike dhe është gjithmonë në kërkim për përvoja të mira pune nga kolegët evropianë dhe shkëmbimeve të praktikave më të mira të inspektimit të drejtësisë dhe forcimit të bashkëpunimit në fushën e përmirësimit të administrimit të drejtësisë.

- **Transparenca:**

Pavarësisht sfidave të hasura, lidhur me infrastrukturën dhe mungesën e burimeve njerëzore, ILD e ka bazuar veprimtarinë e tij në transparencën publike. Kjo është krenaria jonë. Një faqe interneti efikase e projektuar mirë për të ofruar maksimumin e informacionit në lidhje me procesin e ankesave dhe veprimtarinë e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pritja e qytetarëve, komunikimi me median audiovizive e atë të shkruar dhe përgjigjet gjithmonë në afat nga koordinatori për të drejtën e informimit janë dinamika sistematike pune, në funksion të transparencës së institucionit.

- **Edukimi ligjor:**

Edukimi ligjor është një praktikë e qëndrueshme pune e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Njohja me rolin dhe funksionet e institucionit dhe shpjegimi i proceseve të punës në ILD është pjesë e takimeve informuese, që zhvillohen me grupe të ndryshme shoqërore, që nga nxënësit e studentët, tek organizatat e shoqërisë civile, etj. Mikpritja në institucion e nxënësve, studentëve etj., kryhet paralelisht me takime jashtë institucionit, për të bërë paraqitjen e ILD-së tek grupet e ndryshme të interesit, edhe aty ku ata jetojnë, jashtë kryeqytetit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, inspektorë magjistratë e jo magjistratë dhe drejtues e nëpunës të sektorëve të ndryshëm në ILD, angazhohen në takime të tilla ku diskutohet mbi mënyrën se si shihet roli i institucionit, eksperiencat dhe pritshmëritë në raport me sjelljen e magjistratëve në sistem. Ky komunikim direkt nga gjithë stafi i ILD-së ndihmon në rritjen e transparencës, por edhe të efikasitetit të punës së institucionit, e më tej në rritjen e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Faqja jonë zyrtare e internetit <https://ild.al/sq/kreu/> ofron informacion të plotë rreth punës dhe funksionimit të ILD-së dhe është dygjuhëshe, shqip dhe anglisht.



- Spot prezantues ILD



**PJESËMARRËS TË
EDICIONIT TË III-TË TË
AIEN, VIZITË STUDIMORE
NË ILD**

... ..

Paraqitja e Ankesës

Pyetje të shpeshta

© Jap mendimin tene

© jep mendimin tñe

Alte të Inspektorit të Lartë

Raporte dhe Strategji

Raporte Inspektimesh Tematike

Marriveshie

Kirey Breth Nesh Nafitime Legisla

Buletini Nëntor 2025

Buletinul Mușor | ILD®

Abonnyf

8,495+

Ankesa të konfirmuara

6,483

Ankesa të traktuar

2,012

Ankesa në proces trajtimi

144

Magjistratë të hetuar

131

Ankesa në proces verifikimi
pas shqyrtimit fillestar

53

Kërkesa për procedim
disiplinor

Ky informacion rifreskohet çdo të hënë

TOTAL INSPEKTION TIME

21

INSPEKTIVE TË PËRFUNDUARA

15

**HISTORIK
I PËRGJITHSHËM
I PROCESIT DISCIPLINOR
NDAJ MAGJISTRATËVE
NË SHQIPËRI
(1912 – 2025)**

REPUBLIKA Shërbimi i Qytetarit



9 PROFILI NDËRKOMBËTAR I ILD-SË



**RÉSEAU
EUROPÉEN**
DES SERVICES
D'INSPECTION
DE LA JUSTICE

Prej 19 tetorit 2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është anëtar i Rrjetit Evropian i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), që përbëhet nga Belgjika, Bullgaria, Franca, Italia, Spanja, Portugalia dhe Rumania. Në vitin 2025, Rrjeti pranoi edhe Moldavinë si anëtar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë e ka nisur bashkëpunimin me RESIJ në Dhjetor 2021, me iniciativë të Rumanisë e mbështetje të Francës, duke u pranuar në këtë Rrjet fillimisht me statusin e vendit vëzhgues. Që prej Dhjetorit 2021, ILD është angazhuar aktivisht në çdo aktivitet të RESIJ, si në vendet anëtare ashtu edhe jashtë Unionit.

RESIJ, Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë është krijuar në Paris, në Mars 2017, si një iniciativë e Francës, në prani të përfaqësuesve të Bashkimit Evropian e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë të Këshillit të Evropës (CEPEJ). Synimi ishte gjetja e modaliteteve, se si shërbimet kombëtare të inspektimit të drejtësisë të mund të kontribuonin në mënyrë më aktive, në zhvillimin uniform të zonës gjyqësore evropiane të sanksionuar, që nga Traktati i Amsterdamt deri tek Traktati i Romës. Nën modelin e Shqipërisë, RESIJ është hapur edhe për vende të tjera jo të BE, por që janë të avancuar në procesin e negociatave të anëtarësimit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur kontakte me homologë edhe në nivel bilateral, duke filluar nga rajoni, Kosova, Maqedonia e Veriut e Mali i Zi, në Evropë e më tej, Greqi, Francë, Spanjë, Itali, Rumani, Bullgari, Mbretërinë e Holandës, Mbretërinë e Bashkuar, SHBA etj.



Më 24 dhe 25 qershor 2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bashkëpunim me CEPEJ organizoi konferencën ndërkombëtare Tirana 2022 mbi shërbimet e inspektimit të drejtësisë, që bashkoi në kryeqytetin e Shqipërisë, shërbimet e inspektimit të drejtësisë të vendeve të Bashkimit Evropian, anëtarë të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ). Drejtues e përfaqësues të shërbimeve të inspektimit, anëtarë të RESIJ, Drejtues dhe përfaqësues të Shërbimeve të Inspektimit të Belgjikës, Bullgarisë, Francës, Greqisë, Italisë, Portugalisë, Rumanisë, Spanjës dhe Shqipërisë, në varësi të formës së organizimit, funksionimit apo kompetencave, diskutuan mbi temën “Interesi i publikut në administrimin e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve” në tre sesione pune me prezantime, diskutime dhe shkëmbim eksperiencash, idesh dhe kërkimesh të tyre.



Institucione të drejtësisë nga rajoni u bënë bashkë në Tiranë në datat 25 dhe 26 shtator 2025 për konferencën “Shërbimet e inspektimit të drejtësisë dhe sfidat e integritetit”, për të shkëmbyer përvoja, për të trajtuar sfida që lidhen me integritetin gjyqësor dhe për të diskutuar mbi rolin e tyre në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian. Konferenca u realizua si një bashkëpunim mes Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Prezencës së OSBE-së në Tiranë, si dhe misionëve të OSBE-së në Beograd, Podgoricë, Prishtinë, Sarajevë dhe Shkup. Në dy ditët e kësaj konference, diskutimet u fokusuan mbi tre tema të mëdha: parimet dhe funksionimi i shërbimeve të inspektimit, roli i tyre në mbrojtjen e standardeve demokratike dhe promovimin e integritetit, si dhe kontributi i këtyre institucioneve në kontekstin e procesit të integritetit në BE.